



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PUKË
KËSHILLI BASHKIAK

Pukë, më 26.09.2023

Nr.1345/3 prot:

Lënda: Dergojme vendimin e këshillit të Bashkise Puke nr. 25 datë 22.09.2023.

PREFEKTIT TE QARKUT

SHKODËR

Në zbatim të gurmës “a” të nenit 8 dhe pikës 2 të nenit 16 të ligjit me nr.107/2016, “Për Prefektin e Qarkut”, ju dërgojmë bashkëngjitur:

Vendimin e Këshillit Bashkiak Pukë Nr. 25 datë 28.07.2023 per : Për një ndryshim në v.k.b nr. 67, datë 30.12.2022

“Për miratim të nivelit të pagave të punonjësve të Bashkisë Pukë, njësive administrative , institucioneve të varësisë dhe funksioneve të deleguara për vitin 2023”

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin,

SEKRETARE
Edona HYSENAJ





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PUKË
KËSHILLI BASHKIAK



Pukë, më 26.09.2023

Nr. 1345/2 prot:

VENDIM

Nr.25 date 22.09.2023

PËR NJË NDRYSHIM NË V.K.B NR. 67, DATË 30.12.2022

**“PËR MIRATIM TË NIVELIT TË PAGAVE TË PUNONJËSVE TË BASHKISË PUKË,
NJËSIVE ADMINISTRATIVE, INSTITUCIONEVE TË VARËSISË DHE FUNKSIONEVE
TË DELEGUARA PËR VITIN 2023 “**

Në mbështetje dhe zbatim të ligjit nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore” neni 54, gërma ç; neni 55 pika 2; neni 64, gërma j; ligjit nr. 152/2015, datë 21.12.2015 “Për shërbimin e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin”; ligjit nr. 152/2013, datë 26.02.2013 “Për Nëpunësin Civil” i ndryshuar; ligjit nr. 10405, datë 24.03.2011 “Për kompetencat për caktimin e pagave dhe të shpërblimeve” i ndryshuar; ligjit nr.10129, datë 11.05.2009 “Për gjendjen civile” i ndryshuar; ligjit nr. 9936, date 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në RSH”, i ndryshuar; ligjit nr. 57, date 30.04.2020 “Per pyjet dhe shërbimin pyjor”; ligjit nr. 49/2016, datë 05.05.2016 “Për ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9693, datë 19.03.2007, “Për fondin kullosor”, të ndryshuar; ligjit 114/2015, datë 22.10.2015 “ Për auditin e brendshëm në sektorin publik”; ligjit nr. 24/2017 “ Për ujitjen dhe kullimin”; ligjit nr. 8224, datë 15.05.1997 “Për organizimin dhe funksionimin e policisë bashkiake”, i ndryshuar; ligjit nr. 138/2014, datë 24.12.2014 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9780, date 16.07.2007 “Për inspektimin e ndërtimit”, i ndryshuar; ligjit nr. 7961, datë 12.07.1995 “Kodi punës” i ndryshuar; VKM nr. 165, datë 02.03.2016 “Për grupimin e njesive të Vetëqeverisjes vendore, për efekt page dhe caktimin e kufijve të pagave të funksionarëve të zgjedhur e të emëruar, të nëpunësve civil e të punonjësve administrativë të njesive të Vetëqeverisjes vendore”, i ndryshuar; VKM nr. 1108, datë 30.12.2015, “Për transferimin nga Ministria e Bujqësisë, Zhvillimit rural dhe Administrimit të ujërave të Bashkitë, të infrastrukturës së ujitjes dhe kullimit, të personelit dhe aseteve të luajtshme dhe të paluajtshme të bordeve rajonale të kullimit” i ndryshuar; VKM nr. 915, datë 11.11.2015 “ Për transferimin në pronësi nga Keshillat e qarqeve të Bashkitë, të rrjetit të rrugëve rurale dhe të aseteve të luajtshme dhe të paluajtshme të ndërmarrjeve të mirembajtjes së këtyre rrugëve” i ndryshuar; VKM nr. 893, datë 17.12.2014 “ Për miratimin e rregullave të organizimit dhe të funksionimit të kabineteve ndihmëse të organizimit të brendshëm të institucioneve të Administratës Shtetërore si edhe për procedurat e hollësishme për përgatitjen, propozimin, konsultimin dhe miratimin e organizimit të brendshëm; VKM nr. 237, datë 23.04.2014 “Për miratimin e strukturës dhe të organikës së policisë së mbrojtjes nga zjarri dhe të shpëtimit; të VKM-ve të ndryshuara si VKM nr. 604 datë 14.09.2022 “Për përcaktimin e pagës minimale në shkallë vendi”; VKM nr.465 datë 06.07.2022 “ Për disa ndryshime në vendimin nr.175 datë. 08.03.2012 të Këshillit të Ministrave “ Për trajtimin me pagë dhe shtesa mbi pagë të punonjësve mësimore dhe të punonjësve të tjerë jomësimorë në arsimin parauniversitar” të ndryshuar; VKM nr. 621 datë 28.09.2022 “ Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr.187 datë



08.03.2017 të këshillit të ministrave për miratimin e strukturës dhe të niveleve të pagave të pëpunësve civilë/nëpunësve , zëvendësministrit dhe nëpunësve të kabineteve në disa institucione të administratës publike” i ndryshuar; VKM nr.624 datë 28.09.2022” Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr.350 datë 19.04.2017 të këshillit të ministrave për trajtimin me pagë dhe shtesa mbi pagë të punonjësve të shërbimit të mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin” ; VKM nr. 627 datë 28.09.2022 “Për disa ndryshime në vendimin nr.234 datë 20.04.2022 të këshillit të ministrave për pagat e punonjësve mbështetës dhe punonjësve të tjerë të specialiteteve të ndryshme në disa institucione të administratës publike”, VKM nr.625 datë 28.09.2022 “ Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr.165 datë 02.03.2016 të këshillit të ministrave për grupimin e njesive të vetëqeverisjes vendore , për efekt page dhe caktimin e kufijve të pagave të funksionarëve të zgjedhur e të emëruar të nëpunësve civilë e të punonjësve administrativë të njesive të vetëqeverisjes vendore” të ndryshuar; VKM nr. 328 datë, 31.05.2023 ‘Për klasifikimin e funksioneve, për grupimin e njesive të vetëqeverisjes vendore , për efekt page dhe caktimin e kufijve të pagave të funksionarëve të zgjedhur e të emëruar të nëpunësve civilë e të punonjësve administrativë të njesive të vetëqeverisjes vendore”, si dhe VKM, nr. 242, datë 20.04.2023 “Për disa ndryshime në Vendiimin nr.234, datë 20.04.2022 të këshillit të ministrave “ për pagat e punonjësve mbështetës dhe punonjësve të tjerë të specialiteteve të ndryshme në disa institucione të administratës publike”, me propozimin e Drejtorisë së Menaxhimit të Burimeve Njerëzore, Drejtorisë së Administrimit të Përgjithshëm dhe me propozimin e Kryetarit të Bashkisë, Këshilli i Bashkisë:

V E N D O S I:

- 1.Miratimin e nivelit të pagave për punonjësit e Bashkisë Pukë, Njësive Administrative dhe të Shërbimit Pyjor, sipas tabelave bashkëngjitur:
Këshilltarët të paguhen në masën 10% të pagës mujore të Kryetarit të Bashkisë , 105.000 lekë/muaj.
Kryetarët e fshatrave për Qytetin Pukë të paguhen në masën 10% te pagës mujore të Kryetarit të Bashkisë , 105.000 lekë/muaj.
Kryetarët e fshatrave për Njësitë Administrative të paguhen në masen 10% të pagës mujore të Administratorit , 80.000 lekë/muaj.
Vjetërsia e punonjësve të paguhet sipas udhëzimit të Ministrisë së Financave nr. 16.datë 16.06.2023 “Për mënyrën e zbatimit të VKM nr. 325, datë 31.05.2023.
Efektet financiare të shrihen nga data 01.04.2023.
Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkise dhe Administrata.
- 2.Ky vendim hy në fuqi 10 ditë pas shpalljes, sipas ligjit 139/2015, datë 17.12.2015 “ Per veteqeverisjen vendore” , neni 55, pika 6.
- 3.Shpallur me date **26.09.2023**
- 4.Miratuar me 10 vota pro,Vota Pro 10, Vota Kunder 0 , Vota Abstenim 0 .

SEKRETARE

Edona **HYSENAJ**

H/2023

Ne mungese dhe me autorizim

Zv\Kryetari

Enver **SULEJMANI**

